

PERISKOPI



Klubi për
Politikë të
Jashtme



Kosova sa më shpejtë në Këshillin e Evropës

Revistë mujore | Nr. 07 | Dhjetor 2011

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Përmbledhje	3
Rruga drejt Këshillit të Evropës	4
Çfarë është Këshilli i Evropës	4
Struktura e KE-së	6
KE dhe Kosova	7
Anëtarësimi i Kosovës në KE	8
Procedura e anëtarësimit në KE	10
Dobitë dhe dëmet për Kosovën nga anëtarësimi në KE	11
Rekomandime	12

Përmbledhje

Përveç njohjeve nga shtetet e botës, për Kosovën është i rëndësishëm edhe anëtarësimi në institucionet më të rëndësishme në Evropë dhe botë. Ndër institucionet e para në të cilat duhet të kërkojë anëtarësim Kosova është Këshilli i Evropës. Anëtarësimi në këtë organizëm tregon seriozitetin e shtetit dhe i hap rrugë anëtarësimeve edhe në organizma tjerë të rëndësishëm të Evropës.

Autoritetet e Prishtinës duket se janë të vetdijshme për rëndësinë e anëtarësimit në KE dhe kanë hulumtuar mundësitë e Kosovës për anëtarësim në këtë organizatë. Ndihma e disa anëtarëve të KE-së është treguar qenësore në këto përpjekje. Deri tani më shumë se dy të tretat e vendeve anëtare të KE-së e kanë njohur Kosovën, që paraqet vota të mjaftueshme për të marrë vendim për të pranuar Kosovën në këtë bashkësi të vendeve evropiane. Por, ka disa gracka të cilave duhet ikur si dhe disa kushte për t'i plotësuar. Këto kushte kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit, fusha ku Kosova ende duhet të punojë që të ngre standardet.

KE, edhe pse e përçarë rreth statusit të Kosovës, mbetet e interesuar për zhvillimet në Kosovë dhe i përcjell në mënyrë të rregullt. Komisionari për të Drejtat e Njeriut e viziton rregullisht Kosovën dhe raporton për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Asambleja Parlamentare e KE-së ka shqyrtuar dhe miratuar raporte që vëmendjen

më të madhe ia kanë kushtuar çështjes së sundimit të ligjit në Kosovë. KE ka në Prishtinë një zyrë që përkrah projekte të ndryshme në Kosovë, edhe pse gjithmonë duke pasur kujdes që të ruajë neutralitetin karshi statusit të Kosovës.

Këshilli i Evropës, në kohët e fundit, në opinionin publik të Kosovës njihet më së miri për raportin që e ka miratuar në janar të këtij viti të përpiluar nga raportuesi special dhe senatori nga Zvicra, z. Dick Marty. Raporti akuzon lidershipin e lartë politik të Kosovës për përfshirje në krimin e organizuar si dhe për krime të kryera në kohën e luftës, përfshirë edhe trafikimin e organeve të viktimave. Raporti mbetet një temë e hapur ende.

Ky raport i Klubit për Politikë të Jashtme përpiket të japë një pasqyrë të KE-së dhe rëndësisë që ka anëtarësimi në KE. Do të preket edhe puna e autoriteteve të Prishtinës drejt anëtarësimit në KE dhe do të jepen vlerësime për rëndësinë e këtij hapi për Kosovën. Raporti zbulon se përkundër pengesave me të cilat përballët Prishtina, janë bërë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim. Megjithatë, puna nuk ka përfunduar por do të jetë e përfunduar vetëm kur Kosova të bëhet anëtare e KE-së.

Në fund të raportit tërhiqet vërejtja se për Prishtinën njohja ndërkombëtare dhe anëtarësimi në organizma ndërkombëtarë duhet të mbetet prioritet dhe nuk guxon të bëhet peng i zhvillimeve të brendshme politike.



Kryeredaktor:
Alban Bokshi

Redaktore:
Besa Luci

Autor:
KPJ

Fotografite:
COUNCIL OF
EUROPE

Dizajni:
Trembelat

Kontakti
office@foreign-
policyclub.org
+ 381 38 221 881

PËRKRAHUR NGA



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Embassy of Switzerland in the Republic of Kosovo



Rruga drejt Këshillit të Evropës

Përveç njohjeve nga shtetet e botës, për Kosovën është i rëndësishëm edhe anëtarësimi në institucionet më të rëndësishme në Evropë dhe në botë, siç është edhe Këshilli i Evropës. Autoritetet e Kosovës duket të jenë të vetëdijshme për nevojën për anëtarësim në institucione të tilla dhe pohojnë se janë duke punuar në këtë drejtim, por rezultatet lënë shumë për të dëshiruar. Ndër organizmat më të rëndësishëm të Evropës në të cilët duhet të synojë të anëtarësohet Kosova është mu Këshilli i Evropës. Anëtarësimi në këtë organi-

zëm tregon seriozitetin e shtetit dhe i hap rrugë anëtarësimeve edhe në organizma tjerë të rëndësishëm të Evropës.

Këshilli i Evropës është organizatë ndërkombëtare e shteteve evropiane që u themelua pas Luftës së Dytë Botërore duke pasur për qëllim arritjen e bashkëpunimit më të madh të shteteve evropiane dhe ngritjen e besimit midis shteteve e popujve, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, promovimin e demokracisë parlamentare dhe shtetit ligjor, promovimin e standardeve të larta për politikën sociale dhe ligjore, si dhe nxitjen e ndërgjegjësimit për një identitet të përbashkët evropian. Këshilli i Evropës është i ndryshëm prej organizmave të Bashkimit Evropian siç janë Këshilli Evropian, Këshilli i Ministrave të BE-së, etj.

Çfarë është Këshilli i Evropës

Këshilli i Evropës është organizata më e vje-



tër politike në Evropë, e themeluar në vitin 1949. Në vitet pas Luftës së Dytë Botërore, kur Evropa po këndellej nga vuajtjet dhe shkatërrimet e pëpara ndonjëherë në historinë e njerëzimit, pajtimi mes popujve të kontinentit dhe evitimi i luftërave të tjera ishte më i nevojshëm se kurdo herë më parë. Në një fjalim në Universitetin e Cyrihut, Zvicër, në shtator 1946, Sër Winston Churchill thirr për themelimin e Shteteve të Bashkuara të Evropës dhe krijimin e Këshillit të Evropës. Ideja u diskutua në një kongres të qindra udhëheqësve politikë dhe shoqërisë civile të mbajtur në Hagë, Holandë, në vitin 1948. Këshilli i Evropës u themelua më 5 maj 1949 me Traktatin e Londrës nga dhjetë vende: Belgjika, Danimarka, Franca, Holanda, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia dhe Suedia. Vala më e madhe e anëtarësimeve tje- ra është bërë në fillim të viteve 1990, pas rënies së “Perdes së hekur”. Sot, anëtare të Këshillit të

Evropës janë të gjitha shtetet e Evropës përveç Bel- larusisë, Kazakistanit, Vatikanit dhe Kosovës.

Synimet e sotme politike të KE-së, që ka se- linë në Strasburg të Francës, janë artikulluar në tri samite¹ më të vona dhe këto mund të përmbli- den në këto pika: promovimi i vlerave themelore të për- bashkëta të të drejtave të njeriut, shtetit ligjor dhe demokracisë; shtimi i sigurisë së qytetarëve evro- pianë duke luftuar krimin e organizuar dhe trafiki- min e qenieve njerëzore; rritja e bashkëpunimit me organizatat e tjera ndërkombëtare dhe evropiane.

Është me rëndësi të vërehet se edhe pse Këshilli i Evropës nuk ka lidhje me Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi në BE nuk është formalisht i lidhur me anëtarësimin në Këshillin e Evropës, deri më sot asnjë vend nuk është bërë anëtar i BE-së pa u bërë

¹ Varshavë, Poloni, 1993, Stasburg, Francë, 1997 dhe përsëri Varshavë, 2005.



PHOTO COUNCIL OF EUROPE

Në foto, nga majtas:
 Thorbjørn Jagland
 Mevlüt Çavusoglu
 Jean-Paul Costa
 Thomas Hammarberg

Në faqet vijuese:
 Bjorn Von Sydow
 Dick Marty

një herë anëtar i KE-së. Anëtarësimi në KE konfirmon para tërë Evropës se një shtet është i pjekur dhe i përgjegjshëm, i merr mbi vete dhe i përbushë detyrimet që dalin nga konventat e KE-së dhe, ajo që është më e rëndësishmja, dëshmon se ndanë me vendet tjera të Evropës të njëjtat vlera dhe standarde.

Sfruktura e KE-së²

KE kryesohet nga **Sekretari i Përgjithshëm** të cilin e zgjedh Asambleja Parlamentare me mandat pesëvjeçar e i cili e kryeson Sekretariatin e Këshillit të Evropës. Aktualisht, Sekretar i Përgjithshëm është ish-kryeministri i Norvegjisë, Thorbjørn Jagland, i cili ka marrë këtë post më 1 tetor 2009.

Institucioni kryesor vendim-marrës i organizatës është **Komiteti i Ministrave (Ministerialli)** i përbërë nga ministrat e jashtëm të 47 ven-

deve anëtare. Këshilli i Ministrave mbledhet dy here ne vit: para dhe pas seancës së rregullt të Asamblesë Parlamentare. Këshilli i Ministrave mban edhe takime të tjera të cilat mbahen nga zëvendësit e Ministrave të Jashtëm (ambasadorë të përhershëm në KE).

Asambleja Parlamentare (PACE) përbëhet nga parlamentarë të të gjitha vendeve anëtare dhe çdo vit e zgjedh një kryetar tjetër. Në janar 2010, Mevlüt Çavusoglu nga Turqia është zgjedhur Kryetar i Asamblesë Parlamentare. Delegacionet e secilit vend duhet të reflektojnë spektrin politik të parlamenteve të tyre kombëtare, pra të përbëhen nga anëtarë të partisë (partive) në pushtet dhe opozitës. Asambleja Parlamentare është organ deliberativ dhe punimet e rregullta i mban një herë në vit. Vendimet e veta i komunikon në formë të opinionëve apo rekomandimeve. PACE cakton anëtarë të saj si raportues (rapporteurs) me mandat që të përpilojnë raporte parlamentare për çështje specifike.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e ngritur mbi bazë të Konventës Evropiane për të

² Në këtë raport do ti përmendim vetëm institucionet të cilat janë më të rëndësishme për këtë raport. Pra, nuk do t'i rendojmë të gjitha institucionet e Këshillit të Evropës. Për më shumë informata për tërë strukturën e KE-së, shih faqen e KE-së në internet: <http://www.coe.int/>



KE dhe Kosova

KOSOVA SA MË SHPEJTË NË
KËSHILLIN E EVROPËS

Këshilli i Evropës është prezent në Kosovë që nga përfundimi i luftës. KE ka një zyrë në Prishtinë që zbaton një varg projektesh të financuara dhe të mbështetura nga KE. Këto projekte janë të fokusuara kryesisht në arsim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore. KE ka organizuar monitorimin e zgjedhjeve të mbajtura në Kosovë përveç zgjedhjeve të fundit që janë organizuar nga institucionet e shtetit të Kosovës.³

KE është e përfaqësuar edhe formalisht në formë të përfshirjes së konventave të këtij organi në sistemin juridik të Kosovës. Një herë Korniza Kushtetuese e Kosovës e tani Kushtetuta e Kosovës normon aplikimin e dokumenteve të rëndësishme të KE-së si Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut dhe protokollat e saj, Korniza e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare dhe Karta Evropiane e Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare.

KE, edhe pse e përçarë rreth statusit të Kosovës, mbetet e interesuar për zhvillimet në Kosovë dhe i përcjell në mënyrë të rregullt. Komisionari për të Drejtat e Njeriut, z. Thomas Hammarberg, e viziton rregullisht Kosovën dhe raporton për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Asambleja Parlamentare e KE-së më 22 qershor 2010 ka shqyrtuar dhe miratuar raportin e përpiluar nga raportuesi i KE-së nga Komisioni për çështje politike, z. Bjorn Von Sydow, e që vëmendjen më të madhe ia ka kushtuar çështjes së sundimit të ligjit në Kosovë. Sipas z. Sydow, KE në Kosovë duhet të përqendrohet në arritjen e standardeve e jo atë të statusit të Kosovës. Duke folur për standardet në Kosovë, z. Sydow është shprehur para PACE se "Standardet në Kosovë jo vetëm që janë të ulëta por janë ska-

Drejtat e Njeriut të vitit 1950, përbëhet nga gjykatës nga secili vend anëtar të emëruar për mandat gjashtë-vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes, nga Asambleja Parlamentare dhe kryesohet nga Kryetari i Gjykatës që gjithashtu përcaktohet me vota. Që nga viti 2007, Kryetar i Gjykatës është Jean-Paul Costa nga Franca. Sipas provizioneve të reja të përcaktuara me Protokollin Numër 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, qëndrimi në këtë post të gjykatësit do të jetë nëntë vite por pa mundësi të rizgjedhjes.

Komisionari për të Drejtat e Njeriut që votohet nga Asambleja Parlamentare për një mandat gjashtëvjeçar, pa mundësi të ri-zgjedhjes. Ky post është themeluar në vitin 1999. Që nga viti 2006 këtë post e mbanë Thomas Hammarberg nga Suedia.

Ndër institucionet tjera të rëndësishme janë **Drejtoria Evropiane për Kualitetin e Ilaçeve, Konferenca e OJQ-ve Ndërkombëtare, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale** si dhe një numër strukturash gjysmë-autonome të njohura si **"Marrëveshje parciale"** disa nga të cilat janë të hapura edhe për vendet jo-anëtare.

³ KE nuk e njeh Kosovën si shtet të pavarur prandaj edhe nuk ka pranuar të monitorojë zgjedhjet e shpallura nga institucionet e shtetit të Kosovës.



jshmerishtë të ulëta dhe këto mund të përmirësohen edhe pa u marrë me statusin”. E rëndësishme është se PACE bën thirrje për angazhim më të madh të KE-së në Kosovë “për të ngritur standardet në fushën e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit” dhe për t’ia mundësuar popullatës së Kosovës që të gëzojë të drejta çfarë i kërkon Këshilli i Evropës. Për më tepër, PACE kërkon të “niset dialogu me përfaqësuesit politikë të zgjedhur në Kuvendin e Kosovës për çështjet me interes të përbashkët, duke marrë parasysh interesat legjitime dhe shqetësimet e Serbisë”. Kërkesa për angazhim më të madh të KE-së dhe për bashkëpunim me përfaqësuesit politikë të Kosovës sjellin një kualitet të ri në marrëdhëniet mes Kosovës dhe KE-së.

Por, të metat e raportuara para PACE nuk mund të konsiderohen si nisje e mirë e marrëdhënieve të Kosovës me KE-në, pasi PACE vëren lëshime të mëdha në gati të gjitha sferat e jetës shoqërore në Kosovë. Për më tepër, Ministeriali i KE-së, si organi më i lartë vendim-marrës i kësaj organizate, vendimet i merr në bazë të rekomandimeve të PACE. Deri tani, PACE nuk ka pasur fjalë të mira për Kosovën sa për të rekomanduar anëtarësimin në këtë organizatë.

Gjërat janë rënduar edhe më në janar të vitit 2011 kur KE miratoi raportin e senatorit zviceran Dick Mar-

ty që akuzon lidshiripin e lartë politik të Kosovës për përfshirje në krim të organizuar dhe krime lufte. Raporti, që ishte dorëzuar në dhjetor të vitit 2010, ka tërhequr vëmendjen e opinionit publik në tërë globin. Imazhi i Kosovës është dëmtuar rëndë nga ky raport. KE thërret organet hetuese që të hetojnë këto akuza të bëra në raport.

Anëtarësimi i Kosovës në KE

Çështja e anëtarësimit të Kosovës në KE shtrohet së pari si pyetje se a duhet Kosova fare të lodhet të bëhet anëtare e kësaj organizate. Disa përmendin çështjen e implikimeve buxhetore për Kosovën nëse Kosova bëhet anëtare e kësaj organizate e disa të tjerë çështjen nëse Kosova vërtet përfiton nga qasja në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Por, nëse anëtarësimi i Kosovës në BE është vërtetë synim i Prishtinës, atëherë anëtarësimi në KE është një nga kushtet joformale për t’u bërë anëtar i BE-së. Anëtarësimi në KE dëshmon një standard të arritur në zhvillimin e demokracisë, të zhvillimit ekonomik dhe të sundimit të ligjit. Pa e arritur këtë standard atëherë nuk mund të synohet hyrja në BE. Për më tepër, implikimet buxhetore por edhe ato për gjykatat e Kosovës janë të papërfillshme karshi përfitimeve që do të ketë Kosova me anëtarësimin në KE.

Qasja në institucionet e KE-së është, mbi të gjitha, në interes të qytetarëve e jo qeverisë, shpjegon z. Agon Vrenezi, ekspert i të drejtave të njeriut dhe këshilltar në Zyrën e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut. Qytetarët e Kosovës do të përfitonin më së shumti nga anëtarësimi i Kosovës në KE dhe institucionet e saj siç janë Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Komisioni kundër torturimit dhe trafikimit apo Komisioni i Venecias, që janë mbi gjykatat vendore të Kosovës apo vendeve tjera të KE-së ku jetojnë qytetarë të Kosovës. Në këto institucione qytetarët mund të gjejnë mbështetje afërherë kur iu shkelen të drejtat e tyre nga gjykatat vendore. KE mund të luajë rol të rëndësishëm në procedurën e përpilimit të ligjeve duke monitoruar ligjet që miratohen nga Kuvendi i Kosovës si dhe luan rol të rëndësishëm edhe në implementimin e këtyre ligjeve duke monitoruar punën e gjyqësorit të Kosovës.

Anëtarësimi në KE do t'i jepte shtytje pozitive imazhit të përgjithshëm të Kosovës në skenën ndërkombëtare pasi do të shihej si respektuese e vlerave dhe parimeve që janë karakteristike për të gjitha vendet e Evropës. Për më tepër, pjesëmarrja e përfaqësuesve të Kosovës në organet e KE-së do të bëjë jo vetëm që Kosova të shihet si partner i barabartë por do t'i ofrojë mundësi Kosovës që të kontribuojë në debatet në Asamblenë e Përgjithshme dhe në Këshillin e Ministrave dhe të ndikojë në vendimet që merren atje në lidhje me Kosovën.

Sa për koston financiare të anëtarësimit në KE, duket se ajo nuk do të jetë e papërballueshme për Kosovën. Çmimi që duhet të paguajnë shtetet anëtare në buxhetin e përbashkët të KE-së llogaritet në bazë të Rezolutës 94(31) të Këshillit të Ministrave dhe formula e llogaritjes bazohet në numrin e përgjithshëm të popullatës dhe të GDP-së së vendit në tri vitet e fundit. Por, kjo vlen për vendet e mëdha e të pasura të Evropës. Për vendet e vogla dhe me shkallë më të ultë të zhvillimit ekonomik, shuma minimale e kontributit financiar llogaritet në 0,12 për qind e totalit të buxhetit të KE-së. Kjo shumë u kërkohej shumicës së vendeve fqinje të Kosovës dhe parashihet se kaq do t'i kërkohej edhe Kosovës e që llogaritet të jetë rreth 300.000 Euro në vit.

Intervista me zyrtarë të Qeverisë së Kosovës si dhe të Kuvendit të Kosovës zbulojnë se institucionet e Kosovës janë të vetëdijshme për nevojën për anëtarësim në KE dhe se janë bërë disa hapa në këtë drejtim. Megjithatë, puna mund të quhet e përfunduar vetëm afërherë kur Kosova të bëhet anëtare e KE-së. Kosova ka hasur në përkrahje të madhe të vendeve të ndryshme në KE, e sidomos të Shqipërisë, që e ka njoftuar Prishtinën për procedurat për anëtarësim, e ka njoftuar për zhvillimet në KE si dhe ka rekomanduar hapat që duhet ndërmarrë Prishtina.

Znj. Zylfije Hundozi, ish-kryesuese e Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian, tregon se komisioni që ajo ka drejtuar e ka ngritur çështjen e anëtarësimit në KE qysh në pranverën e vitit 2008. "KE ka qenë ndër çështjet e para me të cilat është marrë Komisioni dhe ka rekomanduar që Kuvendi i Kosovës të debatohet për anëtarësimin në KE", shpjegon znj. Hundozi në një intervistë për KPJ-në⁴.

Në shtator të vitit 2009, një delegacion parlamentar i Kosovës është ftuar të vizitojë Asamblenë e Përgjithshme të KE-së dhe dy prej pjesëtarëve të këtij delegacioni, znj. Hundozi dhe z. Bujar Bukoshi, kanë prezantuar para PACE gjendjen në Kosovë. Pjesë e delegacionit kanë qenë edhe anëtarët e Kuvendit të Kosovës, znj. Edita Tahiri dhe Branislav Gërbiq. Të ftuar nga KE kanë qenë edhe znj. Rada Trajković dhe z. Oliver Ivanović, por si delegacion i veçantë.

Z. Agron Demi, analist në Institutin GAP në Prishtinë, tregon se GAP kishte përgatitur një raport të detajuar për KE-në dhe procedurën e anëtarësimit në këtë organizatë me kërkesë të Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian e të cilin e ka dorëzuar në mars të vitit 2008. Z. Demi tregon se procedura e aplikimit dhe anëtarësimit nuk është e thjeshtë dhe kërkohej të arrihen disa standarde para se Kosova të mundet të pranohet në këtë organizatë.⁵

4 Intervistë e KPJ-së me znj. Zylfije Hundozi, Prishtinë, 16.08.2010.

5 Intervistë e KPJ-së me z. Agron Demi, Prishtinë, 29.06.2010.

Kosova ka hasur në përkrahje të madhe të vendeve të ndryshme në KE, e sidomos të Shqipërisë, që e ka njoftuar Prishtinën për procedurat për anëtarësim, e ka njoftuar për zhvillimet në KE si dhe ka rekomanduar hapat që duhet ndërmarrë Prishtina.

70.2%

Deri tani Kosovën e kanë njohur 33 nga 47 shtete anëtare të KE-së, që përbën më shumë se dy të tretat e votave në Këshillin e Ministrave dhe në PACE. Teknikisht, aplikimi i Kosovës për anëtarësim mund të marrë 2/3 e votave në të dy këto organe.

Puna e gjyqeve në arritjen e një niveli të respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit janë vendimtare për anëtarësim, gjë që shihet qartë në rastin e Malit të Zi që ka pasur probleme me anëtarësim mu për shkak të mangësive në sundimin e ligjit.

Burime nga Ministria e Punëve të Jashtme konfirmojnë se MPJ e kishte në programin e saj edhe të vitit 2010 angazhimin për anëtarësim në KE. Një grumbull dokumentesh të siguruara nga KPJ konfirmojnë se MPJ ka qenë e angazhuar gjatë tërë kohës në gjetjen e mënyrave për të aplikuar për anëtarësim në KE. Dokumentet nga MPJ tregojnë se janë studiuar hollësisht dhe në bashkëpunim me zyrtarë të Shqipërisë procedurat e aplikimit dhe anëtarësimit në KE si dhe procedurat e anëtarësimit të disa vendeve, ashtu që Kosova të përgatitet mirë për anëtarësim në KE. Ajo që është kryesorja, autoritetet e Kosovës këtë e kanë bërë në koordinim me vendet anëtare të KE-së e që e përkrahin Kosovën dhe anëtarësimin e saj në KE. Këto edhe i njoftojnë autoritetet e Kosovës për kohën më të përshtatshme për të aplikuar për anëtarësim në këtë organizatë.

Procedura e anëtarësimit në KE

Anëtar i KE-së mund të bëhet çdo shtet evropian që plotëson parimet e Neni 3 të Statutit të KE-së që më saktësisht kërkon të respektohen të drejtat e njeriut dhe parimet e shtetit ligjor. Vendimin për anëtarësim e merr Ministeriali (Këshilli i Ministrave) që mbledhet një herë në vit. Një shtet anëtar i KE-së propozon që të futet në agjendë të mbledhjes së ardhshme të Ministerialit kërkesa për anëtarësim e vendit që ka kërkuar të bëhet anëtar. Para se të marrë vendim për pranimin e anëtarit të ri, Këshilli i Ministrave kërkon opinion apo rekomandim nga Asambleja e Përgjithshme (Avis). Para se të japë mendimin e saj, Asambleja Parlamentare formon një komision që mbikëqyrë nga afër përpunimin e legjislacionit vendor me parimet ligjore të KE-së. Sipas Neni 29 të Statutit të KE-së dhe rregullit 40 të Rregullores së punës së Asamblesë Parlamentare, Komisioni i caktuar nga Asambleja paraqet një raport para Asamblesë dhe në bazë të tij Asambleja, me 2/3 e votave të anëtarëve, merr vendim për apo kundër re-

komandimit për pranimin e një vendi. Rekomandimi apo opinion i Asamblesë Parlamentare ka rëndësi vendimtare me rastin e pranimit apo refuzimit të një shteti të ri në KE. Neni 20 thotë që nëse rekomandimi i Asamblesë Parlamentare është pozitiv, atëherë Këshilli i Ministrave me 2/3 e votave vendos që t'i bëjë ftesë shtetit aplikant për anëtarësim. Përmes Sekretarit të Përgjithshëm, Këshilli i Ministrave i dërgon ftesën për anëtarësim shtetit të ri dhe në ftesë përcaktohet edhe numri i delegatëve që do të përfaqësojnë vendin e ri në Asamblenë Parlamentare, si dhe shuma e caktuar e kontributit financiar vjetor.

Deri tani Kosovën e kanë njohur 33 nga 47 shtete anëtare të KE-së, që përbën më shumë se dy të tretat e votave në Këshillin e Ministrave dhe në PACE. Teknikisht, aplikimi i Kosovës për anëtarësim mund të marrë 2/3 e votave në të dy këto organe. Por, çështja e Kosovës mund të ndërlikohet nëse lihet të shqyrtohet në njërin nga mbledhjet e zëvendësve të Ministrave të Jashtëm në kuadër të Këshillit të Ministrave. Në nivel të zëvendësve të ministrave/ambasadorëve të përhershëm në KE, vendimet për çështjet më të rëndësishme, siç është pranimi i anëtarëve të ri, merren me konsensus⁶. Në KE ka disa kundërshtarë aktivë të pavarësisë së Kosovës që do të votonin kundër anëtarësimit të Kosovës në KE. Prandaj, është qenësore që kërkesa e Kosovës për anëtarësim të shqyrtohet në njërin nga mbledhjet e Këshillit të Ministrave në nivel të Ministrave të jashtëm e jo në nivel të zëvendësve të tyre.

Pas anëtarësimit në KE, në Këshillin e Ministrave Kosova do të përfaqësohej nga Ministri i Jashtëm si

⁶ Sipas Statutit të KE-së dhe Rregullave të punës së Këshillit të Ministrave (Neni 14), çdo anëtar i Këshillit të Ministrave duhet të caktojë një përfaqësues të përhershëm i cili do të zëvendësojë Ministrin e Jashtëm në takimet jo të rregullta të Këshillit të Ministrave. Zëvendësit e Ministrave të Jashtëm kanë kompetenca vendimmarrëse të njëjta me Ministrat e Jashtëm dhe mund të debatojnë të gjitha çështjet të cilat janë në kompetencë edhe të Këshillit të Ministrave në nivel të Ministrave të Jashtëm. Në Rregullat e punës së zëvendësve në Këshillin e Ministrave parashihet edhe vendimmarrja me konsensus për disa çështje me rëndësi, ndër to edhe rreth pranimit apo jo të shteteve të reja në KE.

dhe nga ambasadori i cili do të caktohej si Përfaqësues i Përhershëm në KE. Duke marrë parasysh përfaqësimin e gjertanishëm të vendeve të ndryshme në Asamblenë Parlamentare të KE-së, mund të supozojmë se Kosova do të përfaqësohej me 2 ose 3 deputet në Asamblenë e KE-së, si dhe me 2 apo 3 zëvendës të tyre. Njëri nga ta duhet të jetë femër ngase rregulli kërkon që përbërja e delegacionit të përfaqësojë edhe përbërjen gjinore në kuadër të parlamentit kombëtar. Deputetët zgjidhen zakonisht për një seancë të rregullt, që i bie për një vit të plotë dhe ata duhet të zgjidhen nga përbërja e Kuvendit të Kosovës apo të zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës, e që nënkupton se mund të jenë edhe jo anëtarë të Kuvendit të Kosovës. Lista me përfaqësuesit e zgjedhur duhet t'i dërgohet Asamblesë para se të fillojë seanca e rregullt vjetore. Njëri nga përfaqësuesit duhet që të caktohet edhe si kryetar i grupit të deputetëve nga Kosova.

Dobitë dhe dëmet për Kosovën nga anëtarësimi në KE

Qytetari i Kosovës është ai që përfiton më së shumti nga anëtarësimi i Kosovës në KE. Për qytetarin e Kosovës KE është një mbikëqyrës i sistemit gjyqësor të vendit të tij në të cilin mund të gjejë mbështetje sa herë që sistemi gjyqësor i Kosovës nuk i del krah. Vet sistemi gjyqësor, duke ditur se është i mbikëqyrtur nga një autoritet më i lartë, do të kujdeset që të jetë më kompetent dhe më i përgjegjshëm në punën e vet. Por dobitë shkojnë përtej sistemit gjyqësor. Me konventat e veta, KE do të monitorojë edhe Kuvendin e Kosovës dhe ligjet që miratohen atje, do të monitorojë tërë sistemin për t'u siguruar që nuk do të shkelen të drejtat e asnjë qytetari të Kosovës. Siç vëren z. Vrenezi, anëtarësimi në KE “do të ishte gjë e mirë për ne, për ndëshkim kur thyen ligjet”.

Nga ana ekonomike, siç vëren edhe hulumtimi i Komisionit për Integritet Evropian, anëtarësimi i Kosovës në KE do t'i kushtojë buxhetit të Kosovës dhe vendi nuk do të përfitojë financiarisht nga anëtarësimi i saj në KE. Por këto shpenzime janë pothuajse simbolike për Kosovën, sidomos në krahasim me përfitimet në sistemin gjyqësor dhe përfiti-

Gjërat janë rënduar edhe më në janar të vitit 2011 kur KE miratoi raportin e senatorit zviceran Dick Marty që akuzon lidhshimin e lartë politik të Kosovës për përfshirje në krim të organizuar dhe krime lufte.



met politike që sjell anëtarësimi në KE.

Juridikisht, gjyqësori kosovar do të përfitojë nga anëtarësimi në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu si dhe qytetarët e Republikës së Kosovës. Përfaqësimi i Kosovës në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale do të rrisë efikasitetin e qeverisjes komunale që do të përfitojë ndihmë profesionale me trajnime përmes programeve që ofron ky kongres. Pjesëmarrja e Kosovës në Asamblenë Parlamentare të KE-së do të mundësojë integrimin e Kuvendit të Kosovës për herë të parë në një institucion ndërkombëtar parlamentar dhe kjo do të jetë një përvojë e mirë për integrimin e Kuvendit të Kosovës në të ardhmen edhe në institucionet tjera parlamentare, siç janë Unioni Ndër-Parlamentar dhe Parlamenti i Evropës (BE).

Por, Kosova përfiton edhe në skenën ndërkombëtare nga anëtarësimi në KE. Anëtarësimi është notë pozitive e marrë për të arriturat në respektimin e të drejtave të njeriut dhe në sundimin e ligjit që do të reflektojë pozitivisht edhe në organet tjera ndërkombëtare të globit. Ajo që është me rëndësi, është ky një hap i madh në arritjen e standardeve për t'ua bërë një ditë anëtare e BE-së, që është synim përfundimtar i Prishtinës.

Rekomandime

Autoritetet në Prishtinë duket se janë të vetëdijshme për rëndësinë e anëtarësimit në KE. Këto kanë gjetur partnerë të rëndësishëm në KE, sidomos tek autoritetet e Tiranës. Në koordinim me këta partnerë, Prishtina duket se është duke bërë përgatitjet për anëtarësim në KE. Por, institucionet e Kosovës duhet të shtojnë angazhimin dhe të lojtojnë në Strasburg për këtë. Procedurat për pranim të shteteve të reja janë komplekse dhe të gjata. Që nga ftesa për anëtarësim e deri tek anëtarësimi i plotë i Kosovës në KE mund të kalojë së paku një vit, varësisht nga obligimet që duhet të kryejë Kosova. Prishtina duhet të jetë gati ashtu që në Ministerialin tjetër të aplikojë për anëtarësim në KE. Prishtina duhet të mbetet aktive dhe t'ua riku-

jtojë partnerëve dëshirën për anëtarësim në KE. Edhe pse një numër i madh i vendeve e përkrahin anëtarësimin e Kosovës në KE, kjo nuk do të thotë që anëtarësimi i Kosovës në këtë organ është edhe prioritet i këtyre vendeve. Autoritetet e Prishtinës duhet t'ua përkujtojnë nevojën për anëtarësim në KE dhe të insistojnë që vendet që e përkrahin atë të mbesin aktive në këtë proces.

Përmirësimi i punës së gjyqësorit të Kosovës është ndër kushtet kryesore që Kosova të pranohet si anëtare e Këshillit të Evropës. Sistemi gjyqësor i Kosovës ka shënuar disa suksese në kohët e fundit, duke shtuar efikasitetin e gjyqësorit, edhe pse kjo nuk reflektohet shumë në lajmet për sistemin gjyqësor të Kosovës. Por mbeten edhe shumë sfida për t'ua përballur me to dhe kjo përballje do të jetë kryesore në pranimin e Kosovës në organet më të rëndësishme të Evropës. Sidomos përballja me presionin politik dhe me përfshirjen e politikës në krime do të përcakton shpejtësinë e anëtarësimit të Kosovës në KE. Raporti i Dick Martyt ka dëmtuar rëndë imazhin e Kosovës prandaj institucionet vendore duhet të insistojnë që hetimet e filluara rreth supozimeve të këtij raporti të kryhen sa më shpejt në mënyrë që të hapet rruga për aplikim në KE.

Përmirësimi i të drejtave të njeriut, sundimi i ligjit dhe demokracisë i hapin rrugën Kosovës për anëtarësim në KE por edhe i ndihmojnë asaj për arritjen e këtyre standardeve.

Që nga ftesa për anëtarësim e deri tek anëtarësimi i plotë i Kosovës në KE mund të kalojë së paku një vit, varësisht nga obligimet që duhet të kryejë Kosova.



Synimet e sotme politike të KE-së, që ka selinë në Strasburg të Francës, janë artikuluar në tri samite më të vona dhe këto mund të përmblihen në këto pika: promovimi i vlerave themelore të përbashkëta të të drejtave të njeriut, shtetit ligjor dhe demokracisë; shtimi i sigurisë së qytetarëve evropianë duke luftuar krimin e organizuar dhe trafikimin e qenieve njerëzore; rritja e bashkëpunimit me organizatat e tjera ndërkombëtare dhe evropiane.





Klubi për Politikë të Jashtme është organizatë joqeveritare e cila mbledh rreth vetës intelektual, politikan dhe aktivistë të shquar të shoqërisë civile, që tregojnë afinitet në politikë të jashtme. Klubi ka për qëllim që përmes një debati intelektual të kontribuojë përmes rekomandimeve në gjenerimin e politikave të jashtme të Kosovës, në funksion të paqes në Kosovë, rajon dhe botë. Klubi gjeneron debate, i analizon zhvillimet dhe jep rekomandime për politikën e jashtme të Kosovës; përqendrohet në analizimin e trendeve globale të cilat kanë ndikim në përditshmërinë politiko-ekonomike në Kosovë si dhe në hulumtimin e mundësive që i ofrohen Kosovës në një botë në integrim. Klubi do të përpiqet që të sjell në vëmendje debatet aktuale botërore në opinionin kosovar dhe të tërheqë vëmendjen për hapat e domosdoshëm të politikës kosovare karshi këtyre zhvillimeve.

Klubi përmes aktiviteteve të tij dhe një debati intensiv do të gjenerojë rekomandime dhe programe lidhur me proceset integruese rajonale, evropiane dhe globale, në veçanti në procesin e integritetit në BE dhe NATO, të cilat i vihen në dispozicion institucioneve të Kosovës. Fokus i veçantë i organizatës do të jetë zhvillimi i një debati mbi veprimet imediate që Institucionet e Kosovës duhet t'i ndërmarrin në rrafshin diplomatik në funksion të njohjes së Kosovës nga shtetet anëtare të OKB-së, si dhe pranimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, siç është OKB-ja, KE-ja, OSBE-ja, Banka Botërore, IMF, Organizata e Konferencës Islamike, Komiteti Olimpik etj. Klubi do të ketë për synim që të nxis një debat të fillë përderisa nuk arrihet njohja e Kosovës nga shumica e vendeve botërore dhe pranimi i saj si anëtare e organizatave të lartpërmendura.

BORDI KLUBIT:

Veton Surroi (Kryetar), Valon Murati (Anëtar), Arjeta Emra (Anëtare), Ulpiana Lama (Anëtare), Leonora Kryeziu (Anëtare), Nehat Islami (Anëtar), Lumir Adbixhiku (Anëtar), Agon Vrenezi (Anëtar), Erolld Belegu (Anëtar)

KËSHILLI PROGRAMOR I KLUBIT:

Bujar Bukoshi, Fatmir Gashi, Naser Rugova, Ibrahim Gashi, Sadik Idriz, Fatmir Aliu, Verena Knaus, Mimoza Kusari, Antigona Baxhaku, Luan Shllaku, Lulezim Peci, Haki Abazi, Vlora Çitaku, Venera Hajrullahu, Ilir Dugolli, Ardian Gjini, Erolld Belegu, Gezim Salihu, Agim Zogaj

STAFI I KLUBIT:

Alban Bokshi, Venhar Nushi, Rrahim Sejdiu, Besa Luci, Driton Sylja, Valentina Shyti-Rudi, Kushtrim Dumoshi, Arban Mehmeti, Agim Hoxha.



**Klubi për
Politikë të
Jashtme**